




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Bazuar në nenin 5.2 dhe 8.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Nr.03/L-087, në nenin 39 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 21.05.2012, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 28.05.2012, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR VAZHDIMIN E MANDATIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË KRM "HIGJIENA" NË GJILAN

I

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Gjilanit u vazhdon mandatin anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve: z. **Beqir Hoxha** dhe z. **Shefik Selimi** të cilët në këto pozita janë emëruar sipas vendimit për emërimin e dy anëtarëve në Komisionin komunal të KP "Higjiena", 01.Nr.4828 të datës 29.04.2009.

II

Mandati i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve si në pikën I të këtij vendimi zgjat deri në ristrukturimin e plotë të Kompanisë Rajonale të mbeturinave "Higjiena" në Gjilan. .

III

Komisioni komunal i aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj, dhe për punën e vetë do të paraqesë raport të punës para anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

IV

Komisioni, për punën e kryer do të kompensohet me vendim të veçanët.

V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe Kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-Gjilani

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit,

01.Nr. 16-55993
Gjilan, më 28.05.2012

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues